REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës:	2018:006600
Datë:	06.06.2018
Numri i dokumentit:	00054824

PKR.nr.50/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit N.J. nga fshati ..., Komuna e ..., të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare Av. G.R. nga ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm : KPRK-s) sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I. nr. 46/2018 të datës 02 mars të vitit 2018, pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit fillestar, verbal dhe publik më datën 7 maj të vitit 2018, edhe atë duke pasur parasysh marrëveshjen për pranimin e fajësisë, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit Mr.sc.Agron Uka, si dhe të të pandehurit me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyratare , në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T GJ Y K I M

I. I pandehuri N.J. nga babai M. dhe nëna F., e lindur M., i lindur më data e lindjes..., në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe jeton, posedues i telefonit celular me SIM kartele ..., shqiptar,

2018:006601

shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme – punon si punëtor i thjeshtë në ndërtimtari, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja që gjerë në përfundim të procedurës penale lidhur me këtë çështje penale, se është i detyruar që ta lajmëroj personalisht apo përmes mbrojtësit të tij në rast se eventualisht e ndërron adresën e tij, nën kërcënim të pasojave ligjore lidhur me lëshimin e urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

Ë sh t ë f a j t o r

Sepse më datën 02 shkurt 2018, në intervalin kohor prej orës 14:00 deri ne ora 14:50, në shtëpinë e tij në fshatin ..., Komuna e ..., gjatë bastisjes nga zyrtarët e NJHK në ..., është gjetur armë, te cilen i pandehuri paautorizim dhe në kundershtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrta edhe atë: një revole e markës Zastava (Zorakam) 06-B, me nr. Serik ..., një karikator dhe tre fishekë të kalibrit 7.65mm,

- me çka ka kryer vepër penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së**

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 46, 49, 50-55, neni 73-75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 233 - 247 dhe 365 të Kodit të procedurës penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s) të pandehurit në fjalë,

I SHQIPTON

DËNIM ME GJOBË në shumën prej **katërqind (400) Euro**, të cilën shumë detyrohet që ta paguaj në këste të barabarta në afat prej dy muajve prej nga 200 Euro, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, dënimi lëndor me gjobë të njëjtit,

i zëvendësohet me dënim me burgim prej njëzetë (20) ditëve,

2018:006601

të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së ftesës nga sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale, nën kërëcnim të ekzekutimit të dhunshëm të dënimit. Nëse eventualisht pagesa e gjobës bëhet pjesërisht atëherë në mënyrë përpjestimore do të zëvendësohet me dënim me burgim sipas nenit 46 të KPRK-s.

II. Në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s të pandehurit i shqiptohet **dënimi plotësues** duke ju konfiskuar arma e zjarrtë edhe atë: një revole e markës Zastava - Zorakam 06-B, me nr. serik ..., një karikator si dhe tre fishekë të kalibrit 7.65 mm, të cilat do të shkatërrohen nga ana e komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate,
ndërsa detyrohet **Sektori** për ekzekutimin e sanksiomneve penale i kësaj gjykate që këtë ta konstatoj në procesverabl, duke e vendosur në shkresa të lëndës, po qe se komisioni në fjalë nuk vendos ndryshe konform dispozitave përkatëse ligjore.

III. Detyrohet i pandehuri në fjalë që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale edhe atë përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **pesëdhjetë (50) Euro**, **ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej pesëdhjetë (50) Euro,** të gjitha në afat prej 30 ditëve, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri pesë vjet.

Gjykata Themelore në Gjilan, për këtë lëndë penale sipas rendit të lëndëve ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët. Aktakuzës lëndore i është bashkëngjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë e cila është arritur mes palëve.

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve e në zbatim të nenit 247 lidhur me nenin 233 paragrafi 18-22 të KPP-s ka vendosur që të aprovoj propozimin e përbashkët të palëve, të arritur gjatë negocimit duke pasur parasysh dispozitat e nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s.

2018:006601

Palët kanë mbetur në tërësi pranë marrëveshjes lëndore.

Po ashtu gjykata pas vlerësimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë si dhe të deklaratave të palëve ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 233 paragrafi 18-22 lidhur me nenin 247 dhe 248 paragrafi 1 të KPP-s.

Njëherit gjykata pas pranimit tëmarrëveshjes përkatësisht aprovimit të dënimit të rekomanduar kryesor me gjobë dhe dënimit plotësues, ka vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se me një dënim me gjobë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke u parandaluar edhe i pandehuri edhe qytetarët potencial nga kryerja e ardhshme e veprave të tilla apo të ngjashme.

Gjykata pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, kurse palët shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë andaj edhe në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP më datën **7 maj 2018** ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm.

Zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënim me burgim është bërë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimimin me gjobë qoftë edhe pjesërishtë.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP, ndërsa për taksën e viktimave të krimit në kuptim të nenitn 39 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, në kuptim të nenit 233 dhe 365 të KPP është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda

2018:006601

PKR.nr. 50/2018,më dt.07 maj të vitit 2018

Sekretarja juridike, **Kryetari i trupit gjykues,**

Kadrije Zymberi **Aziz Shaqiri**

<u>Udhëzim për mjetin juridik:</u>

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të Rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

VËREJTJE: Pasi që palët kanë heqë dorë shprehimisht nga e drejta në ankesë në procesverbal, aktgjykimi lëndor bëhet i plotfuqishëm – formës së prerë më datën 7 maj 2018.

2018:006601